

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina
Procedurat për Vendosjen e Tarifave të Furnizimit me
Ujë

Draft preliminar – konceptet themelore etj.

Tetor 2007

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

Procedurat për Vendosjen e Tarifave të Ujit

Draft preliminar – konceptet themelore etj.

Tetor 2007

Përmbajtje

Parathënie	1
1. Përkufizimet	2
2. Konceptet e përgjithshme	4
2.1 Ofruesitë regjional të shërbimeve të furnizimit me ujë	4
2.2 Detyrimet, politika dhe udhëzuesit	4
2.3 Parimet e llogaritjes së tarifave të ujit	4
2.4 Tarifat reale	4
2.5 Eficienca	5
2.6 Procesi i përshtatjes (Smoothing)	Error! Bookmark not defined.
2.7 Pasqyrat financiare	6
3. Shqyrtimi i modelit	6
3.1 Orari	7
3.2 Platforma e modelit	Error! Bookmark not defined.
3.3 Burimet e të dhënave hyrëse	9
3.4 Koncepti i modelit	9
4. Llogaritja e shitjeve	10
4.1 Logjikë	11
4.2 Kërkesat për informacion	11
5. Shqyrtim i kërkesave të të hyrave	13
6. Kostot operative	14
6.1 Pjesa e përgjithshme	14
6.2 Kostot fikse të kostove operative	Error! Bookmark not defined.
6.3 Kostot operative që lidhen me numrin e konsumatorëve	14
6.4 Kostot operative që lidhen me vëllimin e ujit	15
6.5 Kërkesat për informacion	16
7. Amortizimi aktual i kostos	17
7.1 Pjesa e përgjithshme	17
7.2 AKA i aseteve ekzistuese që nuk i përkasin infrastrukturës	17
7.3 AKA i aseteve të reja që nuk i përkasin infrastrukturës	18
7.4 Kërkesat për informacion	18
8. Taksa për përtëritjen e infrastrukturës	20
8.1 Koncepti	20
8.2 Kërkesat për informacion	20
9. Vlera rregullatore e kapitalit	21
9.1 Koncepti	23
9.2 Vlera rregullatore fillestare e kapitalit	23
9.3 Kërkesat për informacion	24

10.	Kthimi në kapital	25
10.1	Koncepti	25
10.2	Kërkesat për informacion.....	25
11.	Llogaritja e tarifave	27
11.1	Koncepti	27
11.2	Tarifa e papërshtatur (unsmoothed) dhe llogaritja e faktorëve individual K të vitit Error! Bookmark not defined.	
11.3	Procesi i përshtatjes (smoothing)	28
11.4	Pasqyrat dhe treguesit financiar	29
12.	Indeksi	30
12.1	Koncepti	30
12.2	Metoda	30
12.3	Shqyrtimet e ardhshme të tarifave dhe vlera rregullatore e kapitalit	31

PARATHËNIE

[Vërejtje: Ky dokument është draft i parë i përkohshëm që do të përdoret vetëm si bazë për diskutim]

Ky draft i parë i procedurave për përcaktimin e tarifave paraqet propozimet inicuese të ZRRUM-it për procesin e llogaritjes së përcaktimit të tarifave. Informacionet e nevojshme për aplikimin e këtyre procedurave mund të mos jenë të gatshme dhe nevojitet një shkallë e diskrecionit rregullator. Kjo nuk do të thotë që nevojiten 'supozimet' e parasyshme por më shumë aplikimi i gjykimit profesional dhe përdorimi maksimal i çfarëdo informacioni që është në dispozicion.

Në këto procedura, me rëndësi është përfshirja e kalendarit rregullator i cili paraqet orarin e hollësishëm për kërkesat e informacioneve, procesin e pranimi, konsultimit si dhe të aprovimit. Është me rëndësi që ZRRUM-i dhe ofruesitë regjionale të shërbimeve të furnizimit me ujë të respektojnë dhe të veprojnë në përputhje me programin e planifikuar me qëllim që të plotësohen afatet e fundit specifike për aplikimin e tarifave të reja.

Një element të rëndësishëm të programit përfshinë zhvillimin e modelit dhe fazën testuese. Kjo kërkon bashkëpunim dhe përkrahje të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë gjatë sigurimit të të dhënave të nevojshme (të audituara dhe të pa audituara) për të mundur që testet e tilla të ndërmerren në atë mënyrë ku rezultatet do të reflektojnë kostot reale dhe performancat e shijëve.

Zbatimi i këtyre procedurave tërësisht varet nga ofruesitë regjionale të shërbimit të furnizimit me ujë në ofrimin e të dhënave të nevojshme për ZRRUM-in. Është me rëndësi që ofruesitë regjionale të shërbimeve të furnizimit me ujë të japin informacionet e kërkuara ZRRUM-it me aplikacionin e tarifave. Nëse është nevoja, informacionet e kërkuara për raportimin periodik duhet të aplikojnë definicionet e ngjajshme si në këto procedura me qëllim që në mënyrë të efektshme të monitorohet performanca aktuale kundrejt supozimeve të bëra në shqyrtimet e tarifave dhe të zvogëlohet mundësia e duplikimit të panevojshëm si dhe të keqinterpretimeve.

Në disa vende, këto procedura ofrojnë variante që duhet të konsiderohen nga ZRRUM-i, përkatësisht: amortizimin aktual të kostos, vlerën rregullatore të kapitalit, kthimin në kapital dhe procesit të përshtatjes (smoothing). Me përjashtim të procesit të përshtatjes (smoothing), ZRRUM-i duhet të kërkojë udhëzim nga qeveria për të vendosur se cili variant është më i përshtatshëm për t'u zbatuar. Rezultatet e programit testues mund të përcaktojnë variantet e zgjedhura.

Këta udhëzuesë përmbajnë komente që janë të paraqitura me *[fontin (shkronjat) italic(e) brenda kllapave të mëdha]*. Këto komente nuk japin përmbajtjen e procedurave por ofrojnë komente që janë përdorur në mënyrë të arsyeshme, në aspektet ku vendimet duhet të mirren dhe të bëhen supozime. Komentet e tilla mund të largohen nga versioni final të udhëzuesve por janë të përfshira në këtë dokument për të ndihmuar debatimin dhe diskutimin para pranimi final të grupit procedurave.

1. PËRKUFIZIMET

Asetet e adoptuara: Asetet fikse financohen nga ndërmarrësi apo shfrytëzuesi ku prona bartet tek ndërmarrja, vlera e së cilës nuk i shtohet vlerës rregullatore të kapitalit.

Ekuivalenca e gjërë: koncepti ku kostot afatgjate të shpenzimeve të mirëmbajtjes janë të krahasueshme me taksat afatgjate të kostos aktuale të amortizimit në gjendje të qëndrueshme.

Modeli tarifar i aseteve kapitale : Asrjetimi ekonomik për përcaktimin e marrëdhënieve të rrezikut të kthimit dhe kthimet e pritura të tipeve specifike të industrisë, p.sh. furnizimi me ujë.

Kontributet e kapitalit: Të hyrat e siguruara si kontribute ndaj investimeve nga pala e tretë, p.sh. taksat e infrastrukturës dhe kontributet për aktivitetet siç janë devijimet në lidhjet e gypave.

Mirëmbajtja e kapitalit: Aktiviteti i planifikuar i kryer nga ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë për të zëvendësuar dhe riparuar asetet e furnizimit me qëllim të krijimit të bazës së shërbimit për konsumatorët.

Kontabiliteti aktual i kostove: Metoda e kontabilitetit, fillimisht e përcaktuar për çështjen e paraqitjes së efektit të inflacionit në fitimet e bizneseve. Në vend që asetet të paraqiten me koston e tyre historike (d.m.th. me çmimin e tyre origjinal të blerjes), pa amortizim nëse është nevoja, asetet janë më mirë ta paraqitura me koston aktuale të tyre (kosto zëvendëse) në kohën e krijimit të llogarive. Kjo metodë e kontabilitetit përdoret në industrinë e ujit sepse karakteri i gjërë i aseteve kapitale dhe fakti që kostot historike nuk reflektojnë vlerën e vërtetë të aseteve. *[në mungesë të kostove të detajizuara të zëvendësimit, kostot aktuale që i nënshtrohen inflacionit mund të aplikohen si zëvendësim i tyre]*

Amortizimi aktual i kostos: Amortizimi i llogaritur në pajtim me metodat aktuale të kontabilitetit të kostos. *[Për asetet ekzistuese propozohet metoda alternative e bazuar në profilin e shlyerjes së borxheve të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë]*

Kostot që lidhen me numrin e konsumatorëve: Kostot operative që lidhen me numrin e konsumatorëve, p.sh. leximi i ujëmatësit, faturimi, etj.

Nivelet e ngritura të shërbimit: Përmirësimet e përhershme, të identifikueshme dhe të matshme të niveleve të shërbimit që janë mbi nivelin bazë.

Përmirësimi: përmirësimi dhe ngritja e bazës së aseteve përmes niveleve të ngritura të përmirësimit dhe/ose zgjerimit të sistemit.

Ex-ante: Metodologjia e llogaritjes e bazuar në projeksionet e kostove dhe të hyrave.

Kostot fikse: Kostot operative që nuk lidhen me numrin e konsumatorëve dhe vëllimin e ujit

Grantet: Të hyrat e siguruara për investimet apo ofrimin e shërbimeve për të cilat nuk kërkohet kurfarë shlyerje e huave. Këtu përfshihet granti që është ekuivalent me shndërrimin e huave të buta në grante dhe huatë komerciale. Investimet e infrastrukturës të financuara nga grantet nuk i shtohen as taksës për përtëritjen e infrastrukturës dhe as vlerës rregullatore të kapitalit.

Të indeksuar: Kostot dhe të hyrat të përshtatura për inflacion në pajtim me indikatorët e inflacionit

Asetet e infrastrukturës: Kryesisht asetet nëntokësore siç janë tubacionet e ujit si dhe pendat e ujit dhe akumulacionet me kohëzgjatje të madhe. Është bërë një dallim në mes të aseteve të infrastrukturës dhe atyre që nuk i përkasin infrastrukturës për shkak të mënyrës së menaxhimit, operimit dhe mirëmbajtjes së aseteve nga ofruesitë regjional të shërbimit të ujit.

Taksat e infrastrukturës: Të paguara nga ndërmarrësitë dhe konsumatorët në pronat e reja për kyçjen e parë të objekteve për qëllimet e amvisërisë furnizimit publik të ujit apo kanalizimit publik.

Taksat për përtëritjen e infrastrukturës: Provizioni i kontabilitetit vjetor për shpenzimet e përtëritjes së aseteve të infrastrukturës (d.m.th. kryesisht nëntokësore) i ngarkuar fitimit rregullator dhe llogarisë së humbjeve.

Faktori K: Faktori i shprehur si përqindje që reflekton rritjet apo uljet reale të tarifave para përshtatjeve të inflacionit.

Uji i Pa-faturuar (UPF): Vëllimi i ujit të trajtuar dhe i cili hyn në sistem që nuk prodhon të hyra për ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë.

Asetet që nuk i përkasin infrastrukturës: Kryesisht asetet mbitokësore siç janë punët që kanë të bëjnë me trajtimin e ujit, stacionet e pompimit dhe laboratorët e kompanive, depotë dhe punëtoritë.

Borxhet e pakompensueshme: Një vlerë e lejuar për pagesat e papaguara ndaj ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë për të cilat nuk ekzistojnë gjasa për t'u paguar dhe të cilat do të konsiderohen si të shlyera në pajtim me praktikën konvencionale të kontabilitetit.

Kostot operative: Kostot direkte operative lidhur me ofrimin e shërbimeve që përfshijnë: fuqinë punëtore; energjinë; kemikaljet; materialet shpenzuese; shpenzimet e paplanifikuara; taksat e pakompensueshme dhe shpenzimet e tjera.

Tarifat reale: Kostot dhe të hyrat e shprehura në tarifa si në datën e vendosjes, p.sh. mesi i 2008.

Kalendari rregullator: Orari i aktiviteteve që duhet të ndërmerren nga ofruesitë regjional të shërbimeve të furnizimit me ujë, ZRRUM-i dhe të tjerët me qëllim të përmbushjes së obligimeve të tyre në afat të caktuar. Aktivitetet përfshijnë përgatitjen e procedurave, konsultimin, testimin, kërkesat për informacion, paraqitjen e tarifave, aprovimin dhe adoptimin e tyre.

Vlera rregulatore e kapitalit: Bazë kapitale e përdorur në kufizimet e vendosjes së tarifave dhe është vlera e ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë e cila fiton kthimin e investimeve. Kjo paraqet vlerën e hapur të investimeve të bëra dhe borxhin, kapitalin e punës, ekuitetin e qeverisë (pjesë e politikës së qeverisë) dhe shpenzimet e reja kapitale. Vlera kapitale llogaritet pas amortizimit aktual të kostos.

Kthimi në kapital: kthimi në vlerën rregulatore të kapitalit i paraqitur si të hyrat vjetore dhe rritja e kapitalit nga investimet të shprehura si përqindje e investimit origjinal.

Kërkesat e të hyrave: Kërkesa e të hyrave vjetore të nevojshme për të financuar aktivitetet e ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë duke përfshirë kthimin në kapital. Këtu përfshihen: kostot operative; taksa për përtëritjen e infrastrukturës; amortizimi aktual i kostos; kthimi në kapital dhe kostot e tjera sipas nevojës.

Premium i rrezikut: Kthimi mbi rrezikun pa kthim që reflekton rrezikun e sektorit ose të biznesit.

Procesi i përshtatjes (Smoothing): Procesi i përshtatjes së tarifave deri te zëvendësimi i ndryshueshmërisë në tarifava me anë të përshtatjeve uniforme (ose gati uniforme) dhe ekuivalente të përqindjes por ende me të njëjtën vlerë aktuale neto të rrjedhjes së të hyrave.

Balancim i kërkesës së furnizimit: Hendeku në mes të furnizimit dhe kërkesës, ose përmes kërkesës nga konsumatorët e rinj apo kërkesën e rritur nga konsumatorët ekzistues për të cilën nevojitet investimi shtesë për të siguruar që kërkesa për shërbimet është plotësuar.

Të painedksuar: Kostot dhe të hyrat që nuk janë të përshtatura për inflacion.

Kostot operative që lidhen me vëllim e ujit: Kostot operative që lidhen me vëllimin e ujit, p.sh. taksat për ujin e papërpunuar, kemikaljet për trajtim dhe energjia për pompim.

Mesatarja e peshuar e kostos kapital (MPKK): Mesatarja e peshuar e interesit të borxhit dhe pritjet e investitorit të shprehur si përqindje e kthimit të kapitalit total.

Kapitali i punës: Kapitali i nevojshëm për të financuar kostot periodike të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë. Në kontekst të këtyre procedurave, kapitali i punës nuk është domosdomërisht përkufizim i saktë i kontabilitetit por më shumë reflekton nevojat aktuale të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë, p.sh. qarkullimi tre mujor.

2. KONCEPTET E PËRGJITHSHME

2.1 Ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë

- 2.1.1 Metodologjia e vënies së tarifave e adoptuar për ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë bazohet në statusin e tyre si entitete publike dhe i nënshtrohen kodit të kompanive të Kosovës. Aktualisht ata nuk prodhojnë dividende për aksionarët e tyre dhe të gjitha të ardhura neto në mënyrë të efektshme ri-investohen në aktivitetet. Kështu që imponimi i regjimit të tarifave që në mënyrë të efektshme dënon performancën e dobët ose që tërheq kthimet shtesë së performancës së mirë është në njëfarë shkalle, kontraproduktive. Edhe pse metodologjia e paraqitur në këto procedura bazohet në parimet konvencionale rregullatoro-ekonomike, elementet më komplekse të përshfaqjeve për performancën e dobët dhe atë të mirë që normalisht vendosen në strukturat e kompanive private (privatizimi i plotë dhe koncesionet afatgjata) nuk kanë rëndësi të madhe dhe kështu që janë të thjeshtëzuar dukshëm në këto procedura. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që ZRRUM-i nuk duhet të ketë interesim në performancën dhe profitabilitetin por më shumë duhet të jetë i kënaqur që ajo performancë është në përputhje me pritjet dhe që ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë janë në rrugë të drejtë në arritjen e qëllimit të qëndrueshmërisë financiare dhe në përmbushjen e obligimeve të tyre të shërbimit në pajtim me standardet e BE-së dhe të Kosovës.

2.2 Obligimet, politika dhe udhëzuesitë

- 2.2.1 Këto procedura paraqesin propozimet e detajuara për vendosjen e tarifave të ujit. Ato bazohen në obligimet ligjore siç është paraparë në *Rregullorën Nr. 2004/49 mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit, Ujërave të Zeza dhe Mbeturinave*. Gjithashtu, këto procedura lidhen me parimet e Politikës Tarifore të Ujit të ZRRUM-it (2007).

2.3 Parimet e llogaritjes së tarifave të ujit

- 2.3.1 Përcaktimi i tarifave të ujit bazohet në çmimet e vendosura për të kënaqur kërkesën e të hyrave të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë. Kjo kërkesë e të hyrave përfshinë, për:
- Kostot operative: fuqia punëtore, energjia, materialet harxhuese, kemikaljet, shpenzimet e përgjithshme, taksat e pakompensueshme dhe shpenzimet e tjera.
- Mirëmbajtja kapitale: taksat për përtëritjen e infrastrukturës, amortizimi dhe mekanizmat e tjerë të përshtatshëm
- Kthimi në kapital: kthimi i drejtë në vlerën rregullatore e kapitalit të aseteve të financuara nga ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë.
- 2.3.2 Parimi themelor i këtyre procedurave është që ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë duhet të kenë rrjedhje të hyrave që është e mjaftueshme për të financuar aktivitetet e tyre por njëkohësisht duhet të sigurojë që kthimi në kapital të kufizohet në paraqitjen e drejtë të investimeve të bëra nga ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë p.sh. investimet e financuara përmes nuk duhet të konsiderohen si kapital mbi të cilin fitohet kthimi.
- 2.3.3 Këto procedura bazohen në shqyrtimin periodik (3 vite).
- 2.3.4 Elementi i rëndësishëm i kërkesës së të hyrave mbi të cilin llogaritet tarifa është financimi i nevojshëm për mirëmbajtjen kapitale, rehabilitimin dhe rregullimin e sistemit. Këto procedura bazohen në supozimin ku provizionet e siguruara në kërkesën e të hyrave reflektojnë shpenzimin aktual. Aty ku shpenzimi është mbi ose nën provizionet e tilla atëherë duhet të bëhen rregullime të përkohshme të tarifave. Kështu që këto procedura janë përcaktuar për të eliminuar, sa është e mundur, nxitjet për shtyerjen e mirëmbajtjes së kapitalit, rehabilitimit si dhe të rregullimit të sistemit.

2.4 Tarifat reale

- 2.4.1 Të gjitha kostot e përcaktuara duhet të përshtaten me nivelin e tarifave në mes të vitit para fillimit të periudhës së shqyrtimit.

- 2.4.2 Tarifa për vitin e parë të periudhës së shqyrtimit duhet të vendoset në bazë të çmimit në mesin e vitit të mëparshëm të shumëzuar me indeksin e inflacionit për vitin e mëparshëm.
- 2.4.3 Tarifat pasuese duhet të përshtaten me shifrat e inflacionit të vitit e mëparshëm.
- 2.4.4 Tarifat duhet t'i nënshtrohen rritjeve (apo uljeve) reale siç është përcaktuar me anë të këtyre procedurave [përshtatje (*unsmoothed*) apo (*smoothed*) varësisht nga qasja e adoptuar]

2.5 Eficienca

- 2.5.1 Në këtë shqyrtim të parë trevjeçar nuk diskutohen kursimet e eficiencës. Megjithatë, në shqyrtimin e ardhshëm procedurat duhet të kenë parasysh çfarëdo përfitime të eficiencës mbi këto të pritura nga ZRRUM-i që të ruhen nga ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë për një periudhë të caktuar [OFWAT lejon që përfitimet e eficiencës të ruhen për pesë vjet] pavarësisht nga koha se kur kjo efizienz do të realizohet.

2.6 Procesi i përshtatjes (Smoothing)

- 2.6.1 Procedurat janë përcaktuar për t'i ulur çmimet gjatë periudhës tre vjeçare të shqyrtimit për të kufizuar ndikimin e kundërt të goditjeve dhe ndryshueshmërive në çmime.

2.7 Pasqyrat financiare

- 2.7.1 Pasqyrat rregullatore financiare të projektuara për ofruesitë regjional të shërbimeve të furnizimit me ujë duhet të jenë rezultat kryesor i këtyre procedurave. Këtu përfshihen:
1. Bilanci rregullator i gjendjes (përfshirë vlerën rregullatore të kapitalit)
 2. Bilanci rregullator i suksesit
 3. Rrjedhja e parasë
- 2.7.2 Pasqyrat financiare të projektuara duhet të krahasohen me performancën aktuale dhe nëse është nevoja mund të përdoren për të identifikuar nxitjet legjitime për përshtatjet e jashtëzakonshme të çmimit (tarifave).

3. SHQYRTIMI I MODELIT

3.1 Orari

3.1.1 Është e nevojshme që ZRRUM-i të formojë 'kalendarin rregullator' duke paraqitur kohën e caktuar për lëshimin e draftit dhe procedurave finale të përcaktimit të tarifave (ky dokument) duke përfshirë kërkesat për informacion, pranimin e propozimeve të tarifave me të dhëna shoqëruese, shqyrtimin e propozimeve dhe vlerësimin e pavarur të tarifave, përgjigjen e ZRRUM-it ndaj propozimeve për tarifa, diskutimet / bisedimet, aprovimin e tarifave dhe adoptimin. Është propozuar orari në vijim për periudhën 2009 – 2011 të shqyrtimit të tarifave:

Jo më vonë se	Aktiviteti	Pala e përgjegjshme
31 Dhjet. 2007	Zhvillimi dhe lëshimi i draftit të Procedurave të Përcaktimit të Tarifave duke përfshirë kërkesat për informacion Fillimi i mbledhjes së të dhënave dhe planifikimi i aktiviteteve	ZRRUM Ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë
31 Janar 2008	Shqyrtimi i procedurave dhe komentet e ofruesve regjional të shërbimeve të furnizimit me ujë	Ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë
28 Shkurt 2008	Vlerësimi i komenteve, shqyrtimi dhe ndryshimi i procedurave dhe lëshimi i Procedurave të korigjuara të Përcaktimit të Tarifave	ZRRUM
30 Prill 2008	'Testimi' preliminar i procedurave duke përdorur të dhëna preliminare	ZRRUM-i në bashkëpunim të ngushtë me ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë
31 Maj 2008	Shqyrtimi i rezultateve të testit, ndryshimi i procedurave (nëse kërkohet) dhe lëshimi i Procedurave Përfundimtare të Përcaktimit të Tarifave	ZRRUM
30 Qersh. 2008	Dorëzimi i propozimeve për tarifa, planet e biznesit dhe informacionet mbështetëse të bazuara në Procedurat Përfundimtare të Përcaktimit të Tarifave	Ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë
30 Shtat. 2008	Shqyrtimi i propozimeve për tarifa duke përfshirë shqyrtimin e hollësishëm të të dhënave të paraqitura dhe përgjigjen zyrtare ndaj ofruesve regjional të shërbimeve të furnizimit me ujë (përfshirë propozimet alternative për tarifa)	ZRRUM
30 Tetor 2008	Aprovimi i tarifave nga ZRRUM-i dhe publikimi	ZRRUM
1 Janar 2009	Adoptimi i tarifave	Ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë
31 Maj 2009	Dorëzimi i të dhënave aktuale të vitit 2008 për krahasim kundrejt projeksioneve të paraqitura në shqyrtimin për tarifa	Ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë
1 Janar 2010	Rregullimi (përshtatja) e tarifave në pajtim me programin tarifor dhe kriterin e inflacionit	Ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë
31 Maj 2010	Dorëzimi i të dhënave aktuale të vitit 2009 për krahasim kundrejt projeksioneve të paraqitura në shqyrtimin tarifor	Ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë
1 Janar 2011	Rregullimi (përshtatja) i tarifave në pajtim me programin tarifor dhe kriterin e inflacionit	Ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë
31 Maj 2011	Dorëzimi i të dhënave aktuale të 2010 për krahasim	Ofruesitë regjional të

	kundrejt projeksioneve të paraqitura në shqyrtimin tarifor	shërbimit të furnizimit me ujë
30 Qersh. 2011	Dorëzimi i propozimeve për tarifa, planeve të biznesit dhe të dhënave mbështetëse të bazuara në Procedura Përfundimtare të Përcaktimit të Tarifave	Ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë

[Orari më lartë bazohet vetëm në vlerësimet fillestare dhe mund të nevojitet orari i korigjuar duke pasur parasysh informacione shtesë. Sidoqoftë, me rëndësi është që në fillim të formohet një orar relativisht i saktë me anë të cilit nuk do të jetë e mundur që të sigurohet përputhja me rezultatet e dëshiruara përfundimtare]

3.2 Platforma e modelit

3.2.1 Procedurat përfshijnë procesin e llogaritjes që përmbanë grupin e faqeve të MS Excel-it *[në këtë draft preliminar ende nuk janë formuar faqet (tabelat)]*. Çdo faqe përmban komponentin specifik të modelit:

1. Kërkesën dhe modelin e shitjeve (emërtues i tarifave)
2. Vlera rregullatore e kapitalit
3. Kërkesa e të hyrave (numëruesi i tarifave)
 - i. Kostot operative
 - ii. Taksa për përtëritjen e infrastrukturës
 - iii. Amortizimi (i llogaritur mbi bazën aktuale të kostos)
 - iv. Kthimi në kapital
 - v. Kostot e tjera *[nëse kërkohen]*
4. Llogaritja e tarifave
 - vi. Tarifat vjetore
 - vii. Tarifat 'e përshtatura'

3.3 Burimet e të dhënave hyrëse

3.3.1 Të dhënat hyrëse të kërkuara në model do të (përfitohen) nxirren nga burimet e ndryshme duke përfshirë:

1. Pasqyrat e audituara (të paaudituar) financiare nga ofruesitë regjional të shërbimeve të furnizimit me ujë, p.sh. bilanci i hollësishëm i suksesit, regjistrat e aseteve, planet e huave, shënimet e qendrave të kostos, raportet e performancës etj.
2. Planet e biznesit të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë, p.sh. prodhimi dhe projeksionet e shitjeve (përfshirë vlerësimet e UPF), projeksionet e inkasimit të të hyrave, planet e investimit të projeksioneve të kostove operative (përfshirë pengesat të mirëmbajtjes kapitale), pritjet e shërbimit të zgjeruar, kërkesat për mbulimin e borxheve (interesi dhe shlyerjet e huave), etj.
3. Qeveria e Kosovës, p.sh. kostoja e kapitalit, politikat lidhur me vlerën rregullatore e kapitalit, etj.
4. Burimet tjera, p.sh. statistikën e inflacionit, normat e interesit, nivelet e të hyrave etj.


3.3.2 Përkufizimet e hollësishme të kërkesave individuale të të dhënave janë të përfshira si shtojca të këtyre procedurave *[nuk janë paraqitur në këtë draft të parë]*.

[Mund të jetë e pamundshme që palët përkatëse të mbledhin dhe të sigurojnë të gjitha të dhëna siç është paraparë në këto procedura për përcaktimin e tarifave në vitin e parë të shqyrtimit tre vjeçar, me cilin rast nga ZRRUM-i, me bashkëpunim me ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë, mund të kërkohet që të bëjë 'vlerësime më të mira' duke u bazuar në të dhënat e disponueshme për ta. Kjo nuk i lejon ofruesitë e shërbimeve të furnizimit me ujë të mos i kryejnë përgjegjësitë e tyre për raportimin e të dhënave por më shumë ata duhet të përmirësojnë sistemet e tyre të informimit për t'i përmbushur kërkesat e

ZRRUM-it. Pritet që gjatë periudhës tre vjeçare të shqyrtimit (2009 – 2011) sistemet e përmirësuara të raportimit të të dhënave do të lejojnë ZRRUM-in të rivlerësojë përcaktimet e tarifave dhe nëse konsiderohet si e përshtatshme, të vendos tarifa bazuar në këto të dhëna përmirësuara.]

3.4 Koncepti i modelit

- 3.4.1 Modeli bazohet në përcaktimin e tarifave për secilin vit që do të jap rrjedhjen e të hyrave që është ekuivalente me kërkesën e të hyrave (përfshirë kthimin në kapital, kur është nevoja). Tarifa mesatare për secilin vit është kërkesa e të hyrave e pjesëtuar me vëllimin e pritur të shitjeve për atë vit.
- 3.4.2 Kërkesa e të hyrave përcaktohet në bazë të përmbushjes së kërkesave reale të rrjedhjes së parasë dhe domosdo nuk i ngarkohen zërat jo-kesh (amortizimi dhe asetet / përshtatjet rivlerësuese të detyrimeve, p.sh. humbjet nga këmbimi i valutës së huaj) përveç ku ngarkesat e tilla konsiderohen si të matura dhe të pranueshme.
- 3.4.3 Kërkesat e të hyrave përfshijnë kostot e efektshme operative, kostot e mirëmbajtjes kapitale dhe kthimin në kapital. [Procesi i vënies së taksave mund të përfshihen në këto kosto por për qëllimet e shqyrtimit aktual të tarifave supozohet se ofruesitë regional të furnizimit me ujë nuk prodhojnë të hyra të mjaftueshme që do të jenë *to detyrueshme për taksa ose që kanë ndërtuar mburojë mjaft të madhe për të mbuluar çfarëdo fitime potenciale që ndryshe do t'i nënshtroheshin procesit të tatimitit*]
- 3.4.4 Trajtimi i mirëmbajtjes së kapitalit varet nëse kostot e tilla janë për mirëmbajtjen e aseteve të infrastrukturës (nëntokësore) apo aseteve që nuk i përkasin infrastrukturës (shih Pjesët 7 dhe 8).
- 3.4.5 Kostot e aktiviteteve operative përfshirë mirëmbajtjen kapitale e aseteve të infrastrukturës, të financuara përmes granteve nuk përfshihen në kërkesën e të hyrave.
- 3.4.6 Investimet kapitale për përmirësimin e infrastrukturës që është financuar përmes granteve nuk përfshihet në vlerën rregullatore të kapitalit.
- 3.4.7 Investimet kapitale në asetet që nuk përkasin infrastrukturës përfshihen në neto VRRK të kontributeve të granteve dhe grantet shlyhen gjatë jetëgjatësisë së aseteve.
- 3.4.8 Vlerat rregullatore kapitale bazohet në vlerën fillestare *[që duhet të përcaktohet]* dhe ngritet përmes investimeve të reja (grantet neto dhe kontributet kapitale) dhe zvogëlohet me anë të amortizimit të llogaritur mbi bazën e kontabilitetit aktual të kostos.
- 3.4.9 Kthimi në kapital bazohet në kthimin e 'drejtë' që reflekton koston e kapitalit ofruesve regional të shërbimit të ujit (normat e interesit dhe pritjet për kthim të ekuitetit).
- 3.4.10 Koncepti i përgjithshëm i procedurave është i ilustruar në Figurën 1.



Figurë 1 – Shqyrtimi i modelit

4. LLOGARITJA E SHITJEVE

4.1 Logjikë

- 4.1.1 Projektionet e përgjithshme të shitjeve bazohen në planet e biznesit të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë por i nënshtrohen shqyrtimit rregullator dhe nëse është nevoja edhe rregullimit (përshtatjes) për të reflektuar pritjet e ZRRUM-it të performancës së përmirësuar.
- 4.1.2 Shitjet e pritura vjetore totale të ujit (m^3) përcaktohen në bazë të:
Shitjet në vit = Shitjet e vitit të kaluar + rritje në prodhim¹ + ulje në UPF
- 4.1.3 Rritjet në prodhim duhet të reflektojnë çfarëdo investime në pritjet e përmirësimit të shërbimit (balancim i kërkesës së furnizimit dhe niveli i shërbimit) përkatësisht zgjerimin e shërbimeve. Ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë duhet të sigurojnë të dhëna mbështetëse kur është nevoja.
- 4.1.4 Projektionet e shitjeve të ujit duhet të ndahen sipas kategorive të konsumatorëve, p.sh. shtëpiak, jo shtëpiak etj. Ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë duhet të sigurojnë të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar vlerësimet e arsyeshme të projeksioneve të tilla sipas kategorive.
- 4.1.5 Numri i projektuar i konsumatorëve (sipas kategorisë) për çdo vit nevojitet për të përcaktuar bazën mbi të cilën përcaktohen të hyrat e taksës së kyçjes dhe largohen nga kërkesa e të hyrave për përcaktimin e tarifave. Në mënyrë të ngjajshme, kostot që lidhen me instalimin e kyçjeve duhet të vlerësohen dhe të përjashtohen nga kërkesa e të hyrave në bazë të asaj ku kostot e tilla përshtaten me taksat e kyçjeve.
- 4.1.6 Vëllimet e projektuara të shitjeve të ujit të bazuara në vlerësimet lidhur me ujëmatësit e gabuar apo të ujëmatësve që nuk janë instaluar, sipas kategorisë nevojiten për të përcaktuar shkallën në të cilin të hyrat mund ndikohen nga programi i matjes dhe nëse ndikimi tejkalon kufijtë e paracaktuar që mund të ndalojë përshtatjen e përkohshme.
- 4.1.7 Projektionet e shitjeve të ujit sipas kategorive duhet të rregullohen në atë mënyrë për të reflektuar borxhet e pakompensueshme (mospagesë). Përshtatjet për borxhet e pakompensueshme duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit të hollësishëm të ZRRUM-it në përcaktimin e nivelit të përshtatshëm të borxheve të pakompensueshme².

4.2 Kërkesat për informacion

- 4.2.1 Kërkesat themelore për informacion për këtë komponent të modelit përfshinë:

Ref	Artikulli	Njësia	Burimi	Shënim
	Projeksionet e vlerësuar të shitjeve të ujit sipas kategorisë	m^3 për vit	plani i biznesit të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë	Shitjet që duhet të identifikohen në bazë të kategorisë së konsumatorit, p.sh. shtëpiak/jo-shtëpiak etj.
	Projeksionet e prodhimit	m^3 për vit	plani i biznesit të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë	Nevojitet për përcaktimin e vëllimit që lidhet me kostot, p.sh. energjia

¹ Ky është rezultati i prodhimit të vlerësuar dhe nuk ngatërrohet me kapacitet të prodhimit.

² Niveli i borxheve të pakompensueshme nuk duhet të përfshijë provizionet për pagesë të vonuar. Borxhet e pakompensueshme përkufizohen si ato për të cilat nuk ka prospekt real të pagesës, p.sh. konsumatorët komercial që nuk kanë qenë në gjendje të paguan, konsumatorët shtëpiak që kanë qenë të shkyçur dhe që nuk kanë treguar gatishmëri për t'u kyçur, të konsumatorët që nuk tregojnë gatishmëri për të paguar dhe sanksionet e shkyçjes ku nuk mund të aplikohen etj. Borxhet e pakompensueshme janë ato që konsiderohen si borxhet e këqija.

Ref	Artikulli	Njësia	Burimi	Shënim
	Projeksionet e UPF	m ³ për vit	plani i biznesit të ofruesve regjional të shërbimi të furnizimit me ujë	UPF që nevojitet për balancim të ujit. Zbritjet në UPF duhet të barazohen me shitjet e ngritura dhe/ose prodhimin e rritur
	Numrat ekzistues dhe të projektuar të konsumatorëve sipas kategorive	No by year	plani i biznesit të ofruesve regjional të shërbimi të furnizimit me ujë	Që të jetë sa më thjeshtë, merrni mesatarën e secilit vit
	Vëllimet e projektuara, të matura dhe pamatura	m ³ për vit	plani i biznesit të ofruesve regjional të shërbimi të furnizimit me ujë	Kjo mund të kërkohej për të vlerësuar përshtatjet e përkohshme të tarifave nëse programi i matjes devijon nga pritjet që rezultojnë në fitimet apo humbjet e tepërta.
	Pritjet e performancës së inkasimit të të hyrave sipas kategorive	% sipas kategorisë dhe vitit	plani i biznesit të ofruesve regjional të shërbimi të furnizimit me ujë	Nevojitet për të përcaktuar shkallën në të cilat tarifat kërkohej të mbulojnë mospagesën.

5. SHQYRTIMI I KËRKESAVE TË TË HYRAVE

- 5.1.1 Kërkesa e të hyrave paraqet të hyrat e kërkuara nga ofruesi regjional të shërbimit të furnizimit me ujë me qëllim që ata t'i përmbushin kostot për kryerjen e aktivitetit të tyre dhe të financojnë programin e tyre investues. Kjo është llogaritur në bazë vjetore në kushtet reale. Komponentët kryesore të kërkesës së të hyrave janë kostot operative, mirëmbajtja kapitale dhe kthimi në kapital.
- 5.1.2 Kostot operative përmbajnë kostot për operimin e sistemit si qëndron në atë vit. Kjo përfshinë kostot operative bazë të shërbimeve dhe ndryshimet neto në kostot operative që lidhen me përmirësimet e kualitetit, zgjerimin e shërbimit dhe ndryshimet në nivelin e shërbimit.
- 5.1.3 Mirëmbajtja e kapitalit përmban koston afatgjate për ruajtjen e sistemeve të aseteve. Kjo është e përbërë nga Taksa për Përtërtijen e Infrastrukturës (TPI) në asetet nëntokësore (të infrastrukturës) dhe taksën e amortizimit³ për asetet mbitokësore (që nuk i takojnë infrastrukturës).
- 5.1.4 Kthimi në kapital është kthimi në vlerën rregullatore të kapitalit (VRRK). VRRK përbëhet prej vlerës inicuese [që do të përcaktohet dhe vendoset nga politika e ZRRUM-it dhe/ose qeverisë] dhe shpenzimet pasuese kapitale, rezultat të amortizimit dhe granteve dhe kontributeve.
- 5.1.5 Norma e kthimit në VRRK përcaktohet në bazë të *[i nënshtrohet vendimit të politikës të ZRRUM-it dhe qeverisë]*.
- 5.1.6 Për këtë shqyrtim të parë nuk ka provizione për vlerat e lejuara stimuluese që do të mbahen për pesë vite pasi që nuk pasur stimulim të mëparshëm të bazuar në shqyrtim të tarifave ku ngarkohen vlerat e tilla të lejuara stimuluese. Shqyrtimet e ardhshme pesë vjeçare duhet të sigurojnë mbajtjen e kursimeve për performancën e mire kapitale dhe operative.

³ Saktësisht, amortizimi duhet të përcaktohet sipas bazës së kontabilitetit aktual të kostos (KAK). Sidoqoftë, është vështirë të besohet që ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë të kenë regjistrat e tyre të kontabilitetit të krijuar për të siguruar vlerësimin gjithëpërfshirës të amortizimit aktual të kostos dhe një qasje të thjeshtë të indeksimit do të ishte më e përshtatshme.

6. KOSTOT OPERATIVE

6.1 Pjesa e përgjithshme

- 6.1.1 Ky kapitull paraqet komponentët e ndryshme të kostove operative të parashikuara për periudhën e shqyrtimit. Kostot e përcaktuara të kostove duhet të përfshihen në kërkesën e të hyrave dhe do të përdoren për të përcaktuar të hyrat e lejuara në secilin vit të periudhës së shqyrtimit.

[Provizionet lidhur me planin e biznesit dhe si do të përcaktohen parashikimet nuk përfshihen në fushëveprimin e këtyre procedurave]

- 6.1.2 Kostot operative klasifikohen sipas tri kategorive. Vlera e kostove operative që duhet të përfshihet në kërkesën e të hyrave dhe që do të përdoret për të përcaktuar të hyrat e lejueshme në secilin vit të periudhës së shqyrtimit (para përshtatjeve dhe korigjimeve) është e barabartë me shumën e tri vlerave që përputhen me kategoritë. Këto tri kategori përfshijnë sin ë vijim:

1. Kostot fikse (që nënkupton kostot operative që nuk lidhen me numrin e konsumatorëve dhe vëllimin e ujit)
2. Kostot operative që lidhen me numrin e konsumatorëve
3. Kostot operative që lidhen me vëllimin (duke iu referuar vëllimit të ujit)

- 6.1.3 Kostot operative duhet të përcaktohen si rezultat i aktiviteteve të tjera dhe/ose aktiviteteve që nuk lidhen me tarifa, p.sh. kostot e kyçjeve të reja që balancohen me të hyrat e taksave të kyçjes.

- 6.1.4 Të gjitha kostot operative do të trajtohen me anë të metodës ex-ante dhe duhet të vlerësohen sipas çmimeve reale (të paindeksuara).

6.2 Kostot operative të kostos fikse

- 6.2.1 Kostot operative fikse sipas granteve dhe kontributeve nuk duhet të përfshihen në kërkesën e të hyrave.

- 6.2.2 Nuk do të ketë përshtatje në të hyrat e lejuara në periudhat pasuese të shqyrtimit të bazuar në atë që shpenzimet e ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë janë më të mëdha ose më të vogla se shumat e përfshira në kërkesën e të hyrave përveç:

1. Deri në atë masë ku ofruesi regjional i shërbimit të furnizimit me ujë nuk i kryen aktivitetet e kërkuara nga manuali i tij O&M, p.sh. mirëmbajtja e zakonshme e kryer më pak se siç është përcaktuar në manual *[i nënshtrohet verifikimit nga ana e auditorit teknik]* në shqyrtimin e ardhshëm të tarifave, ZRRUM-i mund ta zbres shumën e kostove të kursyer nga ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë (bazuar në vlerësimet më të mira) nga kërkesa e të hyrave për periudhën e shqyrtimit në vijim të shqyrtimit e ardhshëm të tarifave.
2. Deri në atë masë ku ofruesi regjional i shërbimit të furnizimit me ujë mund të prodhojë fitimet reale të eficiencës, përfitimet e fitimeve të tilla duhet të qëndrojnë për një periudhë prej pesë viteve. Fitimet e tilla duhet të përfshihen në kërkesën e të hyrave të periudhës pasuese të shqyrtimit.

6.3 Kostot operative që lidhen me numrin e konsumatorëve

- 6.3.1 Kostot operative që lidhen me numrin e konsumatorëve përfshinë ato kosto që drejtohen nga numri i kyçjeve të konsumatorëve, p.sh. leximi i ujmëatës, faturimi dhe inkasimi.

- 6.3.2 Kostot operative që lidhen me numrin e konsumatorëve duhet të përcaktohen në bazë të shënimeve ekzistuese financiare për të përcaktuar koston për konsumator. Pastaj, kjo duhet të ekstrapolohet në numrin e projektuar të konsumatorëve për çdo vit gjatë periudhës së shqyrtimit.

- 6.3.3 Kostot operative që lidhen me numrin e konsumatorëve për konsumator duhet t'i nënshtrohen korigjimit (përshtatjes) për të reflektuar pritjet e eficiencës së përmirësuar të

aktiviteteve të shërbimeve ndaj konsumatorit që rezulton në shfrytëzimin e përmirësuar të resurseve, p.sh. leximi tremujor i ujëmatësit dhe teknologjia e përmirësuar. Pritjet e efijencës duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit të hollësishëm nga ZRRUM-i që do të rezultojë që pritja e koston për konsumator të bie në nivele reale me kohë.

6.4 Kostot operative që lidhen me vëllimin e ujit

6.4.1 Kostot operative që lidhen me vëllimin e ujit përfshijnë

1. Kostot e energjisë elektrike që shfrytëzohen për trajtim dhe pompim
2. Kostot e kemikaljeve të shfrytëzuara për trajtim (përfshirë dozimin tretësor të klorit)
3. Kostot e ujit të papërpunuar

6.4.2 Shënim:

- V_t Kostot variable për metër kub të ujit të shitur dhe të paguar, që janë shfrytëzuar për kërkesën e të hyrave për vitin t
- Q_t Sasia e parashikuar e ujit të shitur për vitin t
- EL_t Kosto e parashikuar e energjisë elektrike për pompimin për metër kub të ujit të pompuar për vitin t
- CH_t Kosto e parashikuar e kemikaljeve për metër kub të ujit të trajtuar për vitin t
- RE_t Ngarkesa (tarifa) e parashikuar e ujit të papërpunuar apo për marrjen e ujit për metër kub të ujit të blerë apo të marrë për vitin t
- Ψ Koeficienti i parashikuar apo i përcaktuar që është i barabartë me:
Sasia e pompuar, trajtuar apo e prodhuar (si do të jetë rasti)
 Sasia e shitur (d.m.th. e faturuar)
- Ψ_{ELt} Lidhur me ujin e pompuar në vit
- Ψ_{CHt} Lidhur me ujin e trajtuar në vit t
- Ψ_{REt} Lidhur me ujin e blerë të papërpunuar apo të prodhuar (d.m.th. uji që hyn në sistemin e shpërndarjes) në vitin t , ujit të trajtuar në vitin t
- CE_t Efijencia e përcaktuar(parashikuar) e inkasimit për vit t , e barabartë me:
 të hyrat e inkasuara / të hyrat e faturuara

6.4.3 V_t përcaktohet si në vijim:

$$V_t = \frac{(EL_t \times \Psi_{ELt}) + (CH_t \times \Psi_{CHt}) + (RW_t \times \Psi_{REt})}{CE_t}$$

6.4.4 Vlera $V_t \times Q_t$ përfshihet në kërkesën për të hyrat për vitin t të periudhës së shqyrtimit.

6.5 Kërkesat për informacion

6.5.1 Kërkesat themelore për informacion për këtë komponent të modelit përfshijnë:

Ref	Artikulli	Njësia	Burim	Shënim
	Projeksionet kostove operative fikse (që nuk lidhen me numrin e konsumatorëve të vëllimit të ujit të prodhuar ose shitur), p.sh. fuqi punëtore, mirëmbajtja e zakonshme etj.	EUR	Regjistrat financiar dhe planet e biznesit të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë	Bazuar në kostot + ose – çfarëdo devijimi i pritur, p.sh. rritjet e pagave etj. Të sigurojë që kostot lidhur me aktivitetet e tjera (jo-kryesore) apo aktivitetet e financuara në mënyrë alternative, p.sh. kyçjet e reja përjashtohen, Identifikimi dhe klasifikimi i kostove të financuara nga grantet apo burimet e tjera.

Ref	Artikulli	Njësia	Burim	Shënim
	Kosto operative që lidhen me konsumatorë, p.sh. leximi i ujëmatësit, faturimi dhe inkasimi.	EUR	Regjistrat financiar dhe planet e biznesit të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë	Bazuar në kostot + ose – çfarëdo devijimi i pritur, p.sh. rritjet e pagave etj. Identifikimi dhe klasifikimi i kostove të financuara nga grantet apo burimet e tjera.
	Kostot operative dhe projeksionet lidhur me vëllimin e ujit	EUR	Regjistrat financiar dhe planet e biznesit të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë	Të përfshijë kostot siç është paraqitur në pikën 6.4, p.sh. energjia, kemikaljet, blerja e ujit të papërpunuar etj. Identifikimi dhe klasifikimi i kostove të financuara nga grantet apo burimet e tjera.

7. AMORTIZIMI I KOSTOS AKTUALE

7.1 Pjesa e përgjithshme

- 7.1.1 Asetet fikse të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë ndahen gjerësisht në dy kategori – asetet nëntokësore (apo të infrastrukturës) dhe asetet sipërfaqësore (mbitokësore) (ose joinfrastrukturore). Asetet nëntokësore nuk amortizohen mirëpo shpenzimet që ruajnë nivelin e shërbimeve ndaj konsumatorëve të rrjetit përfshihen në taksën për përtëritjen e infrastrukturës. (TPI)
- 7.1.2 Kërkesa për të hyrat përfshinë elementin për koston e zëvendësimit të aseteve të amortizueshme të shtrihen përgjatë afatit ekonomik të aseteve. Kjo është taksa e amortizimit aktual të koston (AAK).

7.2 AKA i aseteve ekzistuese jo-infrastrukturore

- 7.2.1 Qasja konvencionale është që AKA i aseteve ekzistuese jo-infrastrukturore në fillim të vitit bazë është një element hyrës në këtë model.

[Përcaktimi i vlerës së AKA në asetet ekzistuese është e mundur që të tregohet si problematike për shkak të faktorëve të ndryshëm duke përfshirë: pa e ditur se çka janë vlerat reale të Asetit Modern Ekuivalent (AME) dhe rezultatin e provizioneve të AKA, duke mos e ditur se si janë financuar asetet e tilla, p.sh. grantet, huatë apo investimet e ekuitetit, duke mos ditur se çfarë ndikimi do të kenë në lirim të borxheve etj. Më mirë se të ndërmerret analiza e hollësishme dhe gjithëpërfshirëse e aseteve dhe provizioneve të amortizimit, përgjigja e cila do të jetë pak më shumë se një supozim i saktë është qasja alternative e paraqitur në këto procedura si në vijim:]

Varianti A

- 7.2.2 Konsideron amortizimin si 'kthim në kapital'. Në këtë rast obligimet financiare për kthimin në kapital janë në mënyrë efektive, shlyerja e obligimeve ndaj borxheve afatgjate. Kështu që vlera e fillestare e AKA mund të përcaktohet në bazë të Vlerës Aktuale Neto të rrjedhjes së shlyerjes së borxheve ekzistuese (por jo pasuese). Më vonë kjo mund të zhvendoset në nivelin e përshtatur (smoothed) (uniform ose që gradualisht ngritet ose bie) që AKA të aplikohet gjatë periudhës së specifikuar, të themi 10 deri 20 vite.

Varianti B

- 7.2.3 Varianti i qasjes së lartpërmendur mund të jetë njësi hyrëse për shlyerjen e borxheve në kërkesën e të hyrave në bazë çdo vjeçare, d.m.th. përshtatje e bazuar në VAN. Kjo siguron rrjedhjen e mjaftueshme të parasë për t'i përmbushur obligimet e shlyerjes së borxheve vit pas viti. Në këtë bazë, AKA në asetet ekzistues jo-infrastrukturore do të bie gjatë kohës kur bëhet shlyerja e borxheve në mënyrë graduale. Në të njëjtën mënyrë, VRRK e bazës së asetit origjinal gjithashtu do të zvogëlohet por VRRK e përgjithshme do të rritet me vendosjen e investimeve të reja.
- 7.2.4 Me përdorimin e cilito variant më lartë, ky komponent i kërkesës së të hyrave i / nuk [e debatueshme, shih shënimin në fund të paragrafit] i nënshtrohet indeksimit të inflacionit. [Mund të ketë argumentime lidhur me atë se përderisa shlyerja e obligimeve të huave në EUR do të mbetet konstante pavarësisht nga inflacioni atëherë nuk do të ketë kërkesë që do të ketë parasysh përshtatjet e inflacionit (edhe pse çfarëdo obligime të shlyerjes së huave në valutat e huaja mund ende të kenë nevojë të indeksohen kundrejt lëkundjeve në shkallën e shkëmbimit). Mund të ketë kundërshtime në atë që ky komponent duhet, në fakt, t'i nënshtrohet indeksimit meqenëse shlyerja e borxheve është përfshirë në kthimin e fituara të cilat duhet të mbrohen kundrejt ndikimeve të kundërta të inflacionit. Duke pasur parasysh indeksimin, llogaritja e tarifave nuk bëhet dukshëm e thjeshtë pasi nuk ka nevojë të bëhet ndarja e elementeve të indeksuar dhe të pa indeksuar të VRRK dhe AKA.]

Mund të ketë argumentime që pjesa e dukshme e huave afatgjate të ofruesve të shërbimit të furnizimit me ujë është për investimet në asetet e infrastrukturës (nëntokësore) për të cilët nuk duhet të ngarkohet amortizimi dhe kështu që nevojitet një. apportionment i borxhit në mes të aseteve të infrastrukturës dhe aseteve që nuk i takojnë infrastrukturës. Megjithatë, nëse kjo qasje adoptohet atëherë ajo do të kërkojë që një pjesë e vlerës së lejuar për

përtëritjen e infrastrukturës do të shfrytëzohet për shlyerjen e borxheve dhe re-borroëing do të jetë i nevojshëm për të përmbushur nivelin e pritur të përtëritjes. Vështirë që do të jetë në gjendje ofruesi i shërbimit të furnizimit me ujë të marr hua për aktivitetet e përtëritjes së infrastrukturës, së paku për periudhë afatshkurte, dhe kështu që është mirë të mirren parasysh të gjitha obligimet e shlyerjes së borxheve që të zëvendësohen për AKA në asetet ekzistuese.]

7.3 AAK në asetet e reja jo-infrastrukturore

7.3.1 AAK në investimet e reja llogaritet në bazë të drejtë, në pajtim me jetëgjatësinë e aseteve të tyre përkatëse. Në të njëjtën mënyrë grantet dhe kontributet në asetet mbikotësore shlyhen gjatë jetëgjatësisë së aseteve.

[Financimi i investimeve në Kosovë përmes huave të buta është ndonjëherë me normat shumë të ulëta të interesit dhe periodave grejs dhe provizionet e shlyerjes. Është e debatueshme çështja nëse ofruesitë regjional të shërbimeve të furnizimit me ujë duhet të kenë të drejtë për kthim të plotë të kapitalit për investimet e financuara në kushte të tilla. Rekomandohet që çfarëdo projekte të financuara me anë të huave të buta të tilla analizohen dhe ri-llogariten (vetëm për qëllime të tarifave) në kombinim të granteve dhe huave komerciale ekuivalente ku ndryshimi në mes të vlerës së huasë dhe NPV të profilit të shlyerjes së borxheve, përfshirë interesin (të zbritur sipas normës komerciale commercial lendin rate) është, vlera e grantit ekuivalent. Sipas kësaj baze, komponenti i përcaktuar i grantit trajtohet si çfarëdo granti tjetër në përputhje me këto procedura.]

7.3.2 Proporcionet e investimit kapital në çdo kategori të jetëgjatësisë së aseteve janë të vendosura veçmas për mirëmbajtje, përmirësim të kualiteti, balancim të kërkesës së furnizimit dhe shpenzimet e niveleve të përmirësuar të shërbimeve. Shpërndarja e granteve dhe kontributeve të kapitalit të pranuar në mes të kategorive të kohëzgjatjes së aseteve janë gjithashtu pjesët e modelit.

7.3.3 Nëse qëndrueshmëria e shërbimit të grupit të aseteve joinfrastrukturore është në gjendje të mirë dhe jetëgjatësia ekonomike e aseteve është ekuivalente me jetëgjatësinë e tyre të shërbimit atëherë shpenzimet kapitale afatgjata të mirëmbajtjes për përtëritjen dhe zëvendësimin e bazës së aseteve (shpenzimet jo-infrastrukturore të mirëmbajtjes) dhe taksa e amortizimit aktual të kosto për ato asete duhet të jenë të krahasueshme. (koncepti i Ekuivalencës së Gjërë). Gjendja e qëndrueshme për ekuivalencën e gjërë nuk pritet në periudhën e shqyrtimit dhe investimet e nevojshme për përmirësimin e aseteve deri në nivele të kërkuara të shërbimit gjatë periudhës së zgjatur do të rezultojë në nivelet e ngirtura të AAK në dhe mbi vlerën e lejuar për AAK në asetet ekzistuese (të përcaktuar në bazë të obligimeve të shlyerjes së huave).

7.4 Kërkesat për informacion

7.4.1 Kërkesat themelore për informacion për këtë komponent të këtij modeli përfshijnë:

Ref	Artikulli	Njësia	Burimi	Shënim
	Obligimet e borxheve ekzistuese afatgjata (shlyerja e profilit themelor)	EUR në vit	Shënimet financiare dhe planet e biznesit të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë	Identifikoni dhe ndani obligimet e shlyerjes në valutë të huaj.
	Planet për mirëmbajtjen kapitale të aseteve që nuk i takojnë ifrastrukturës.	EUR në vit	Planet e investimeve dhe planet e biznesit të ofruesve regjional të furnizimit me ujë	Gjykim i kërkuar për të përcaktuar nëse investimet janë për MK apo përmirësimin. Ndikimi i tarifave është i parëndësishëm dhe kështu që saktësia e gjykimit nuk është aq edhe me rëndësi. Identifikoni dhe klasifikoni çfarëdo investime të financuara nga grantet dhe burimet e tjera.

Ref	Artikulli	Njësia	Burimi	Shënim
	Investimet në përmirësimin e jo-infrastrukturës i ndarë sipas aktivitetit, p.sh. kualiteti, zgjerimi etj.	EUR në vit	Shënimet financiare dhe planet e biznesit të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë	Identifikoni dhe veçoni çfarëdo investime të financuara nga grantet dhe burimet tjera.
	Jetëgjatësia e shfrytëzimit të aseteve	Vitet	Politika e ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë	ZRRUM-i duhet të jetë i kënaqur që jetëgjatësia e aseteve reflekton pritjet reale të jetëgjatësisë së aseteve.
	Hollësitë e financimit të investimeve p.sh. interesi etj.	Plani	Planet e investimit të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë	Vendimi i kërkuar lidhur me shndërrimin e huave të buta në grant dhe ekuivalentet e huave.

8. TAKSAT PËR PËRTËRITJEN E INFRASTRUKTURËS

8.1 Koncepti

- 8.1.1 Kontabiliteti për përtëritjen e infrastrukturës përdoret për asetet nëntokësore se sa në amortizimin konvencional. Taksa për përtëritjen e infrastrukturës (TPI) prodhohet çdo vit dhe përfshihet në kërkesën për informacion. TPI reflekton mesataren e shpenzimeve për përtëritjen e infrastrukturës (SHPI) gjatë periudhës kohore.
- 8.1.2 TPI përcaktohet në bazë të shpenzimit të nevojshëm për ruajtjen e nivelit bazë të shërbimit dhe për të përjashtuar shpenzimet të përmirësimit të infrastrukturës që është përfshirë në VRRK. Përmirësimi i infrastrukturës përfshinë shpenzimet e bëra për të përmirësuar kualitetin e ujit, nivelet e shërbimit dhe shpenzimet për plotësimin e balancimit të furnizimit / kërkesës (përfshirë zgjerimin e shërbimit).

[Është e njohur që mund të ketë punë të pabërë të përwritjes së infrastrukturës që kërkohej të rrisë kualitetin e nivelit të shërbimit në nivelin e kërkuar. Vështirë që propozimi i programit për përtëritjen e infrastrukturës mund të jetë në gjendje që qartë të identifikoj zbatimin në mënyrë që të ndajë punën e pakryer nga ajo e duhura për ta mbajtur nivelin e ulët aktual të shërbimeve. Shkalla e diskrecionit rregullator është e nevojshme në këtë instancë për ta përcaktuar vlerësimin e shumave që duhet të financohen nga TPI dhe ajo t'i shtohet VRRK. Më tutje, ajo bëhet me komplekse ashtu që TPI do të duhet të rritet në mënyrë progresive që të ofrojë nivelin e përmirësuar të shërbimeve. E thjeshtë, meqë e ashpër, metodologjia është për ta përcaktuar domosdo TPI të mbajë nivelin ekzistues të ulët të shërbimeve që duhet të përputhen me nivelin e përgjithshëm të shërbimeve dhe progresivisht të rrisë TPI në bazë të drejtpërdrejtë për periudhën me të cilën niveli i përgjithshëm i shërbimeve arrihet. Bilanci i shpenzimeve në infrastrukturë mund që me efekt të shtohet VRRK. Ky problem thjeshtohet kur investimet infrastrukturale financohen nga grantet, në përputhje me konceptin e TPI, shpenzimet e infrastrukturës të financuara nga grantet (përtëritjet dhe përmirësimet) nuk i shtohet as VRRK dhe as nuk përfshihet në TPI]

- 8.1.3 Grantet kapitale dhe kontributet për përtëritjen e infrastrukturës nuk përfshihen në kërkesën e të hyrave.

[Nëse vendosen huatë e buta atëherë komponenti ekuivalent i grantit nuk duhet të përfshihet në kërkesën e të hyrave.]

8.2 Kërkesat për informacion

- 8.2.1 Kërkesat themelore për informacion për këtë komponent të modelit përfshijnë:

Ref	Artikulli	Njësia	Burimi	Shënim
	Programi për shpenzimet për përtëritjen e infrastrukturës	EUR në vit	Planet e biznesit të ofruesve regional të furnizimit me ujë	Vendimi i nevojshëm për të ndarë përtëritjet normale nga backlog ku kjo e fundit duhet të konsiderohet si përmirësim i shërbimeve dhe duhet t'i shtohet vlerës rregullatore të kapitalit. Identifikoni dhe veçoni çfarëdo kosto të financuara nga grantet dhe burimet e tjera.
	Projeksionet e kërkesës së rritur	Plani	Planet e investimit të ofruesve regional të shërbimit të furnizimit me ujë	Vendimi i politikës e nevojitur lidhur me shndërrimin e huave të buta në ekuivalentet e granteve dhe të huave.

9. TAKSAT E INFRASTRUKTURËS DHE KONTRIBUTET

9.1 Taksat e infrastrukturës

- 9.1.1 Taksat e infrastrukturës paguhen nga ndërmarrësitë dhe konsumatorët në pronat e reja si për kyçjet e para në objektet për qëllimet e amvisërisë në furnizimin publik të ujit ose kanalizimit publik. Kjo taksë duhet të mbulojë koston të përmirësimit të rrjetit shpërndarës që të përmbushë kërkesën e krijuar nga kyçja e objekteve të reja gjatë kohës.
- 9.1.2 Taksat e infrastrukturës duhet të kufizohen në kostot e përmirësimit të rrjetit që përfshinë stacionet e pompimit dhe rezervuarët deponuese por që nuk përfshinë punët që kanë të bëjnë me burimet e ujit dhe pajisjet për trajtimin e ujit.
- 9.1.3 Taksat e infrastrukturës duhet të përcaktohen në bazë të kostove marginale afatgjate të investimeve të reja për banesë me shkallë të zbritjes të vendosur në shkallë të njëjtë të kthimit rregullator në kapital.
- 9.1.4 Modeli për përcaktimin e taksave të infrastrukturës duhet të jetë me kohëzgjatje minimum deri në 15 vjet por modelet afatgjate duhet të zhvillohen kur është nevoja.
- 9.1.5 Vlera rregullatore e kapitali duhet të jetë kosto e investimit që është rezultat i taksës së infrastrukturës.
- 9.1.6 Pa plane të hollësishme të investimeve, kompanitë duhet të vendosin vlerën e llogaritur të taksave të infrastrukturës që përcaktohen nga ZRRUM-i, vlerën e cila nuk duhet të përfshihet në vlerën rregullatore të kapitalit.

9.2 Kontributet kapitale

- 9.2.1 Kontributet kapitale paguhen nga ndërmarrësi dhe konsumatorët për zhvillim të infrastrukturës që është specifik për nevojat e ndërmarrësitë apo konsumatorët, p.sh. gypat e ri për fabrikën dhe për të mbuluar koston për përmirësimin që rrjeti shpërndarës të përmbushë kërkesën shtesë.
- 9.2.2 Sikur taksat e infrastrukturës ashtu edhe kontributet kapitale duhet të kufizohen në kostot e çfarëdo infrastrukture dhe përmirësimit të rrjetit duke përfshirë stacionet e pompimit dhe rezervuarët deponuese por duke mos përfshirë punët që kanë të bëjnë me burimin e ujit dhe pajisjet për trajtimin e ujit. *[Ka argumentime lidhur me kontributet ndaj pajisjeve të reja të trajtimit dhe punëve që kanë të bëjnë me burimin e ujit kur rritja e pritjes e kërkuar është e lartë. Kjo duhet të shqyrtohet më shumë].*
- 9.2.3 Kontributet kapitale duhet të përcaktohen duke u bazuar në kostot reale të përmbushjes së kërkesës shtesë ose duhet të përcaktohen në bazë të kostove marginale afatgjate të investimit të ri për m³ të ujit të pritjes që furnizohet me shkallën e zbritjes të vendosur në shkallë të njëjtë si kthimi rregullator në kapital cilido që është i përshtatshëm⁴.
- 9.2.4 Vlera rregullatore e kapitalit duhet të jetë kosto e investimeve neto të çfarëdo kontributeve.

9.3 Kërkesat për informacion

- 9.3.1 Kërkesat themelore të informacionit për këtë komponent të modelit përfshijnë:

⁴ Aty ku investimi i ri është specifik për konsumator individual apo ndërmarrësi, përcaktimi i kontributit kapital është i drejtpërdrejtë. Kudo që është bërë investimi për shërbime të disa konsumatorëve potencial apo ndërmarrësit në kohë ndryshme ose që është ndarë me konsumatorët ekzistues nevojitet një qasje më e ndërlikuar e rrjedhjes së parasë për të përcaktuar shpërndarjet përkatëse të kontributeve.

Ref	Artikulli	Njësia	Burimet	Shënim
	Shpenzimi i infrastrukturës për përmbushjen e balancimit të kërkesës së furnizimit	EUR në vit	Planet e investimeve të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë	Duhet të ndahen për të identifikuar që është kërkuar për të kënaqur kërkesën e rritur të amvisërisë lidhur me kyçjet e reja, d.m.th. duke përjashtuar kërkesën e rritur për shkak të konsumit të rritur për kokë banori dhe që është kërkuar për të përmbushur kërkesën që lidhet me ndërmarrësit specifik / konsumatorët për përcaktimin e kontributeve kapitale. Plani i investimeve për ta ndarë aktivitetet e infrastrukturës nga ato që nuk i takojnë infrastrukturës.
	Kyçjet e reja të projektuara (shtëpiake dhe komerciale)	Schedule	Planet e biznesit të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë	Programi vjetor i nevojshëm për përcaktimin e kostove marginale afatgjata.
	Shpenzimet e infrastrukturës për plotësimin e nevojave specifike të konsumatorëve për kontributet kapitale	EUR në vit	Planet e investimeve të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë	Për investimet e kërkuara për më shumë se një ndërmarrës / konsumator, shpenzimet duhet të zbërthehen në bazë vjetore për përcaktimin e kostove marginale afatgjata.
	Kërkesa e projektuar e rritur e ujit	Plani	Planet e biznesit të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë	Për të ndarë në mënyrë të qartë kërkesën që lidhet me kyçjet e reja, i.e. duke përjashtuar kërkesën e rritur për shkak të rritjes së konsumit për kokë banori dhe që është kërkuar për të plotësuar kërkesën që lidhet me ndërmarrësit specifik / konsumatorët për përcaktimin e kontributeve kapitale.

10. VLERA RREGULLATORE E KAPITALIT

10.1 Koncepti

- 10.1.1 Vlera rregullatore e kapitalit (VRRK) paraqet bazën e kapitalit mbi të cilin ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë e kanë drejtën për kthim. Ajo paraqet nivelin e investimeve të bëra tek ofruesitë regjional të shërbimit me furnizim me ujë nga investitorët dhe huadhënësit (ekuiteti dhe borxhi).
- 10.1.2 Vlera fillestare e VRRK në vitin bazë është element hyrës i modelit financiar.
- 10.1.3 Shpenzimet kapitale për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit përfshihen në VRRK. Çfarëdo granti apo kontribute të kapitalit përjashtohen nga kostoja e asetëve të reja. Amortizimi aktual i kostot largohet nga VRRK çdo vit.
- 10.1.4 Shpenzimi për përtëritjen e infrastrukturës (SHPI) nuk përfshihet në VRRK.

10.2 Vlera rregullatore fillestare e kapitalit

[Vlera fillestare rregullatore e kapitalit është çështje e rëndësishme që kërkon vendim të matur nga qeveria dhe ZRRUM-i. Pozicionet themelore për qeverinë dhe ZRRUM-in për të cilat duhet vendosur përfshijnë: vlerën e ekuitetit komunal (lidhur me atë se cili është kthimi i prituri në ekuitet të komunave), provizionet për kapitalin e punës dhe trajtimi i borxhit. Disa variante që duhet të mirren parasysh janë në vijim:]

Varianti A

- 10.2.1 VRRK të çdo ofruesi regjional të shërbimit të furnizimit me ujë është vlera e borxhit afatgjatë⁵ plus provizion për kapitalin e punës. Komponenti i borxhit të VRRK nuk duhet t'i nënshtrohet indeksimit në shqyrtimin periodik përderisa niveli i borxhit nuk ndryshon me inflacion. Përshtatjet e VRRK duhet të bëhen për të reflektuar lëkundjet në shkallën e shkëmbimit të borxhetit dhe mbajtura në valutë të huaj. Shlyerja e borxheve duhet të rezultojë në rënie të VRRK por duhet të kompensohet me investimet pasuese në përmirësimin e infrastrukturës dhe asetet jo-infrastrukturore. *[Në mënyrë tjetër, VRRK mund t'i nënshtrohet indeksimit duke reflektuar vendosjen e kapitalit pavarësisht nga ajo a është përdorur për repay e huave apo për marrjen sipër të investimeve të mëtejshme. Kjo qasje alternative jep një tarifë pak më të lartë por procesi i llogaritjes bëhet dukshëm më i thjeshtë].*

[Përparësi themelore me këtë opcion është që jep tarifën më të ulët por ajo do të rritet progresivisht përderisa bëhen investimet e reja duke rezultuar në kthimet e rritura në kapital dhe AKA. Mangësia është që komunat në mënyrë efektive vlerësojnë ekuitetin e tyre si zero.]

Varianti B

- 10.2.2 VRRK e ofruesve regjional të shërbimeve të furnizimit me ujë është vlera e borxheve afatgjata plus shuma nominale e ekuitetit komunal [që do të përcaktohet] plus provizioni për kapitalin e punës. Vlera e ekuitetit komunal dhe kapitalit të punës duhet t'i nënshtrohen indeksimit në shqyrtimin periodik. *[shiko lartë, të gjitha VRRK mund t'i nënshtrohen procesit të indeksimit.]*

[Ky opcion jep një tarifë më të lartë që përfshinë kthimin në ekuitetin komunal. Vlera rregullatore e ekuitetit komunal mund të përcaktohet në mënyrë arbitrare dhe nuk ka nevojë të reflektojë vlerësimin e asetëve].

Varianti C

- 10.2.3 VRRK të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë është vlera neto aktuale e kostos të asetëve të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë. Totali i VRRK duhet t'i nënshtrohet procesit të indeksimit në shqyrtimet periodike.

⁵ Vlera e borxhit mund të përshtatet për të reflektuar ndikimin e huave të buta, d.m.th të shndërrojnë nivelin aktual të borxheve në grant dhe huatë komerciale dhe vetëm e fundit të trajtohet si VRRK.

[Ky opcion jep tarifën më të lartë. Është për t'u vënë në pyetje nëse opcioni i tillë është i përshtatshëm pasi shumë asete mund të jenë të dhuruara apo financuara nga grantet dhe huave të buta.. Kjo mund të rezultojë në rrjedhjen pozitive të parasë të ofruesve regional të shërbimit të furnizimit me ujë dhe mund të mos ndihmojnë eficientësi financiare dhe ekonomike. Ky variant nuk rekomandohet]

- 10.2.4 Provizionit për kapitalin inicues të punës duhet të reflektojë të ardhura të nevojshme për aktivitetet e përditshme të ofruesve regional të shërbimit të furnizimit me ujë (dhe mund të përjashtojë llogaritë e arkëtueshme). Vlera e kapitalit të punës brenda VRRK duhet t'i nënshtrohet procesit të indeksimit në shqyrtimin periodik. *[Niveli i kapitalit inicues të punës mund të bëhet në mënyrë arbitrare, p.sh. qarkullim 3 mujor].*
- 10.2.5 Në të ardhmen nuk duhet të ketë përshtatje të kapitalit të punës se përmes indeksimit të VRRK totale.

10.3 Kërkesat për informacion

- 10.3.1 Kërkesat themelore të informacionit për këtë komponent të modelit përfshijnë:

Ref	Artikulli	Njësia	Burimi	Shënim
	Vlera rregullatore fillestare e kapitalit përfshirë kapitalin e punës.	EUR	Shënimet financiare të ofruesve regional të furnizimit me ujë dhe politika e qeverisë	Vendimi rregullator / i qeverisë për politikën e kërkuar lidhur me ekuivalentin komunal. Vendimi për politikën e kërkuar për përcaktimin e kërkesës fillestare të kapitalit të punës.
	Pengesat në përtëritjen e infrastrukturës dhe programi për përmirësimin e infrastrukturës	EUR në vit	Shënimet financiare të ofruesve regional të shërbimit të furnizimit me ujë dhe planet e biznesit	Identifikoni dhe klasifikoni çfarëdo kosto të financuara nga grantet dhe burimet e tjera.
	MK e jo-infrastrukturës dhe programi i përmirësimit	EUR në vit	Shënimet financiare dhe planet e biznesit të ofruesve regional të shërbimit të furnizimit me ujë	Identifikoni dhe klasifikoni çfarëdo kosto tjera të financuara nga grantet ose burimet e tjera.
	Hollësitë e financimit të investimeve p.sh. interesi etj.	Plani	Planet e investimit të ofruesve regional të shërbimit të furnizimit me ujë	Vendimi për politikën e kërkuar lidhur me shndërrimin e huave të buta në grantet e ekuivalentet e huave.

11. KTHIMI NË KAPITAL

11.1 Koncepti

- 11.1.1 Kthimi në VRRK është kthimi real, d.m.th. i përshtatur për inflacion.

[Si me përcaktimin e vlerës së VRRK, kthimi në kapitali është çështje për t'u debatuar dhe çështje e politikës së qeverisë. A duhen ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë të fitojnë kthim që është ekuivalent me kthimet komerciale për aktivitetet e ngjajshme të rrezikut në Kosovë ose kudo, duke e ditur që janë ndërmarrje publike? A duhet kthimi i kapitalit të vendoset sipas normës së interesit të përcaktuar nga qeveria, etj.? Duke ditur që opsionet për përcaktimin e nivelit të VRRK mund, në fakt, të rezultojnë në VRRK të ulët lidhur me asetet e përgjithshme, ndikimin që kthimi në VRRK mund të ketë në tarifa mund të jetë minimal, së paku në vitet e hershme. Megjithatë, në bazë të asaj që huatë e buta mund të shndërrohen në kombinim ekuivalent të VAN të granteve dhe huave komerciale, kthimi në VRRK duhet së paku të jetë i krahasueshëm me commercial borrowing rates normat komerciale të huamarrjes. Kërkesa e qeverisë për investimet e mëdha të sektorit privat në sektor do të kërkojë që kthimet në VRRK (së paku atë element të financuar nga sektori privat) të jenë të krahasueshme me pritjet e kthimeve të ngjajshme të rrezikut. Megjithatë, do të ishte jo reale që në periudhë shumë të shkurt të vendoset kthimi në VRRK që do të përshtaten me pritjet e sektorit privat derisa nuk ka angazhim të until there is a firm commitment to attract private sector financing. Kështu që këto procedura paraqesin disa variante aktuale për vendosjen e kthimit në VRRK, në vijim:]

Varianti A

- 11.1.2 Vendosja e kthimit në VRRK për të reflektuar koston komerciale të huamarrje (pa inflacion) për një organizatë siç ku përfshihet ofruesi regjional i shërbimit të furnizimit me ujë plus [opcionale] premium i vogël [që duhet të përcaktohet] për të reflektuar pritjet e ekuitetit për kthime.

[Kjo qasje më e thjeshtë dhe përveç të premiumit të vogël arsytohet më lehtë. Sidoqoftë, kjo mund të mos i kënaq pritjet e investimeve të ardhshme të sektorit privat.]

Varianti B

- 11.1.3 Vendosja e kthimit në VRRK në bazë të mesatarja e peshuar e kostos kapitale (MPKK) ku komponenti i borxhit reflekton interesin e pagueshëm në borxhet iniciuese të VRRK ku elementi i ekuitetit reflekton kthimin në çfarëdo VRRK shtesë (pavarësisht nga ajo nëse financimi është bërë përmes huamarrjes ose ekuitetit) në normë komerciale të kapitalit (pa i inflacion)..

[Rezultati i këtij varianti është kthimi i rritur në kapital është kthimi i rritur në kapital si raport i VRRK deri te ndryshimet e reja në VRRK me investimet e reja të cilat do të mund të përcaktojnë ekuivalentin e mesatarës. Llogaritja e kthimit në VRRK mund, megjithatë të bëhet e komplikuar.]

Variant C

- 11.1.4 Vendosja e kthimit në VRRK duke përdorur Modelin Tarifor të Aseteve Kapitale (MTAK) ku kthimi është shumë e normës reale të interesit 'pa rrezik' plus premiumi i rrezikut për industri. *[Dihet që informacionet e tregut në Kosovë nuk janë mjaft të sofistikuar për të mundësuar analizën e hollësishme të MTAK. Si alternative mund të jetë e mundur të vendosen rezultatet e përcaktimit të tarifave nga OFWAT në Angli / Uells, d.m.th. përdorimi i premiumit të rrezikut të përcaktuar nga OFWAT për industrinë e ujit. Kjo domosdoshmërisht mund të mos jetë reflektim real i rrezikut të industrisë së ujit në Kosovë (duke përjashtuar rrezikun politik të vendit) por mund të konsiderohet si një zëvendësim i pranueshëm.]*
- 11.1.5 Norma reale e interesit 'pa rrezik' mund të bazohet në bondet e thesarit të Euro-zonës të qeverisë (të përshtatura për inflacion). *[Ky variant në mënyrë të efektshme vendos pamjen për tërheqjen e investimeve private në sektor ku kthimet në ofertën për investimet e reja janë të krahasueshme me pritjet e sektorit privat. I vetmi element që mungon është provizionit për rrezikun e vendit pa të cilin investimet e jashtme nuk do të jenë të mundshme. Sumë qeveri të Euro-zonës lëshojnë bondet e thesarit të cilat mund të sigurojnë matjen e duhur të kthimit pa rrezik. Rreziku i vendit brenda të cilit reflektohet Euro-zona me anë të*

mospërputhjeve në shkallë – edhe pse në përgjithësi, shkalla e mospërputhjeve është mjaft e vogël. Pasi Kosova nuk është në Euro-zonën, rreziku i vendit mund të jetë më i lartë se sa shumë më i lartë brenda zonës. ZRRUM-i duhet të konsultohet me bankën qendrore të Kosovës për të përcaktuar nivelin premiumit të rrezikut të vendit.]

11.2 Kërkesat për informacion

11.2.1 Kërkuesat themelore të informacionit (që varen nga varianti i zgjedhur) për këtë komponent të modelit përfshijnë:

Ref	Artikulli	Njësia	Burimi	Shënim
	Kthimet reale pa rrezik	Norma	Prodhime të bondeve të thesarit të qeverisë të përshtatura për inflacion dhe rreziku i vendit të Kosovës	Kjo varet nga shkalla e ndërlikimeve në treg për bondet e qeverisë dhe matja e prodhimeve. Kjo mund të përfshijë rrezikun e vendit por jo domosdo edhe perceptimet e investitorit për rrezikun e vendit.
	Premium i rrezikut të industrisë	Norma	Përcaktimet e OFWAT (ose zëvendësim tjetër i ngjajshëm)	Përdorimi i të dhënave të OFWAT janë ndoshta e vetmja alternativë e qëndrueshme edhe pse premiumi i rrezikut për industri për ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë mund të shihet si dukshëm më i lartë se që është përcaktuar nga OFWAT për Anglinë/Uellsin.
	Kosto aktual e borxhit	Norma	Shënimet financiare të ofruesve regjional të shërbimit të furnizimit me ujë	Aplikohet vetëm për borxhin dhe përjashton obligimet e reja financiare.

11.2.2 Në të gjitha raste vendimet e politikës kërkohen për të përcaktuar kthim më të përshtatshëm të vlerës rregullatore të kapitalit.

12. LLOGARITJA E TARIFAVE

12.1 Koncepti

- 12.1.1 Tarifat e ujit për m³ përcaktohen në bazë të shumës së kostove të mirëmbajtjes operative dhe kapitale dhe kthimin në vlerën rregullatore të kapitalit të pjesëtuar me pritjet e vëllimit të ujit të shitur dhe të paguar.
- 12.1.2 Tarifat mund të vendosen në bazë të tarifave të përshtatura dhe të papërshtatura (smoothed ose unsmoothed).
- 12.1.3 Për opcionin e tarifave të papërshtatura (unsmoothed), tarifat përfundimtare përcaktohen në bazë vit pas viti të shprehura në kushte reale. Kjo do të rezultojë në rritjet apo uljet vjetore të tarifave në kushtet reale (faktorët K). Tarifat përfundimtare të papërshtatura (unsmoothed) do të përshtaten çdo vit sipas shkallës së inflacionit siç është përcaktuar me anë të indeksit retail price index (RPI) plus faktori K.
- 12.1.4 Për tarifën e përshtatura (smoothed), vlera uniforme (konstante) K përcaktohet se sjellë VAN si të tarifën e përshtatura (unsmoothed). Për këtë janë në dispozicion disa variante. Nuk është e përshtatshme që në këto procedura të ceket metoda precize e cila duhet të adoptohet por më shumë duhet të ndërmerren analizat mbi bazën e papërshtatur (unsmoothed) dhe pastaj të shqyrtohen së pari implikimet e procesit të përshtatjes (smoothing) para marrjes së vendimit. Pavarësisht nga ajo se pse duhet të pranohet opcioni i procesit të përshtatjes (smoothing), llogaritja duhet të sjellë të njëjtën VAN si në opcionin e tarifave të papërshtatura (unsmoothed).

Varianti A

- 12.1.5 Tarifa përcaktohet me vlerën K prej zero, d.m.th. tarifa përfundimtare për periudhën e shqyrtimit është uniforme në kushtet reale gjatë periudhës dhe e vetme është që lejohet të ngritet sipas shkallës së inflacionit.

Varianti B

Tarifa përcaktohet me vlerën uniforme K duke u nisur nga tarifa aktuale para shqyrtimit, d.m.th. rritjet e tarifave (apo uljet) çdo vit duke përfshirë përshtatjet inicuese që janë uniforme në kuptim të përqindjes. Kjo shmangë mundësinë e paraqitjes së goditjes së tarifave të vitit të parë. Megjithatë, kjo mund të rezultojë në mungesë të rrjedhjes së parasë për ofruesitë regional të shërbimit të furnizimit me ujë në vitet e hershme nëse tarifa ekzistuese është kryesisht më e ulët se ajo e përcaktuar në bazë vjetore. *[Është për t'u vënë pyetje nëse ofruesitë regional të shërbimit të furnizimit me ujë gëzojnë kufijtë e mjaftueshëm për të mundësuar kërkesat e tilla afatshkurta të rrjedhjes së parasë dhe nëse jo, ofruesitë regional të shërbimit të furnizimit me ujë mund të mos jenë në gjendje të përmbushin programin e planifikuar të mirëmbajtjes kapitale]*

Varianti C

- 12.1.6 Tarifa përcaktohet në bazë të vitit 1 të tarifave të vendosura në nivelin e unsmoothed për vitin 1 me vlerën uniforme K për përshtatjet vazhduese dy vjeçare. Kjo mund të rezultojë në goditje të çmimit në vit të parë (në vazhdim të përshtatjeve uniforme) por mbron ofruesitë regional të shërbimit të furnizimit me ujë kundrejt mungesave të dëmshme.

12.2 Tarifat e papërshtatura (unsmoothed) dhe llogaritja e faktorëve individual K të vitit

- 12.2.1 Tarifa mesatare përfundimtare (T_{ave}) për secilin vit (t) llogaritet si:

$$T_{ave(t)} = \frac{\text{Shpenzimet operative}_{(t)} + \text{Mirëmbajtja Kapitale}_{(t)} + \text{Kthimi në VRRK}_{(t)}}{\text{Sasia e ujit të shitur}_{(t)} \times \text{Eficienca e inkasimit}_{(t)}}$$

Ku:

Shpenzimet operative =

Kostot fikse + kostot që lidhen me numrin e konsumatorëve + kostot operative që lidhen me vëllimin e ujit

Mirëmbajtja e kapitalit =

TPI + AKA (existing non-inf. assets) + AKA (neë non-inf. assets)

Kthimi në VRRK = Norma e kthimit në VRRK x VRRK

Sasia e ujit të shitur = Vëllimi total (m³) i faturuar për çdo vit, dhe

Efiçienca e inkasimit=

(shumat e faturuara – faturimet e pambulueshme (pakompensueshme) shumat e pranuar / shumat e faturuara

- 12.2.2 Nëse tarifat relative (shkallët) për kategoritë e ndryshme të tarifave ndryshohen gjatë periudhës së shqyrtimit atëherë është e nevojshme që të përcaktohet tarifa individuale për secilën kategori.
- 12.2.3 Për përcaktimin e tarifave të kategorisë individuale aplikohet formula më lartë por sasia e ujit të shitur përshtatet me tarifën ekuivalente të amvisërisë (T_D) dhe efiçienca e inkasimit përcaktohet në bazë të efiçencës së matur për secilën kategori. Kategoritë pasuese të tarifave përcaktohen duke shumëzuar nomrën e përcaktuar ekuivalente të amvisërisë me shkallët përkatëse.

$$T_{D(t)} = \frac{\text{Shpenzimet operative}_{(t)} + \text{Mirëmbajtja e kapitalit}_{(t)} + \text{Kthimi në VRRK}_{(t)}}{[Q_{D(t)} \times CE_{D(t)}] + \sum \text{Weighting}(\text{Peshimi})_{X(t)} \times (Q_{X(t)} \times CE_{X(t)})}$$

Ku:

Q_D = Vëllimi i ujit të shitur në (at the domestic rate),

CE_D = Efiçienca e inkasimit të shitjeve shtëpiake

Weighting_x = Tarifa për kategorinë X të konsumatorëve / Tarifa e amvisërisë

Q_x = Vëllimi i ujit të shitur kategorisë X së konsumatorëve

CE_x = Efiçienca e inkasimit për kategorinë X të konsumatorëve

- 12.2.4 Tarifat përfundimtare, mesatare dhe ato sipas kategorisë zbërthehen në komponentet përbërëse të tyre të kostove operative, mirëmbajtjes së kapitalit, kthimit të kapitalit të shprehur si EUR për m³ për qëllime ilustrative dhe analitike.
- 12.2.5 Rezultati për secilin vit do të identifikojë tarifën (viti 1) dhe rritjet dhe uljet reale të përqindjes për vitet pasuese, të njohura si vlerat K, të llogaritura si:

$$K_t = [\text{Tarifa e pa-indeksuar}_t / \text{Tarifa e pa-indeksuar}_{t-1}] - 1$$

Ku:

K_t = faktori K për vitin t

- 12.2.6 Aty ku shkallët e tarifave të kategorive të ndryshmendryshojnë gjatë periudhës së shqyrtimit do të jetë e nevojshme që të përcaktohen tarifat individuale të paindeksuar dhe faktori individual K për secilin komponent të tarfiave, p.sh. nëse politika ishte gati të mbyll hapësirën në mes të tarifave të amvisërisë dhe të tarifave që nuk i përkasin amvisërisë, atëherë faktori K për tarifën e amvisërisë do të ishte më i madh se faktori K për tarifat që nuk i përkasin amvisërisë.

12.3 Procesi i përshtatjes (Smoothing)

- 12.3.1 Llogaritja e përshtatjes (smoothing) do të varet nga varianti i zgjedhur.
- 12.3.2 Baza e llogaritjes duhet të përcaktojë faktorin uniform K për periudhën e shqyrtimit që do të jep Vlerën Aktuale Neto (VAN) të rrjedhjes totale të hyrave të barabartë me VAN të rrjedhjes të të hyrave.
- 12.3.3 Shkalla e zbritjes që do të përdoret është kthimi i përcaktuar i vlerës rregullatore të kapitalit.

[Metodologjia ellogaritjes për këtë është relativisht e thjeshtë. Rrjedhja e të hyrave të të hyrave unsmoothed është e barabartë me kërkesën e të hyrave, kështu që NPV të rrjedhjes së të hyrave pa kërkesën e të hyrave është zero. Vendosja e parë e tarifës së vitit të parë dhe vlera arbitrare e K e cilamë vonë vendos tarifën vijuese të viti dhe përcakton rrjedhjen e të hyrave neto të bazuara në shitjet të secilit vit të shumëzuar me tarifën e tyre përkatëse pa kërkesën e të hyrave. Përdorimi i funksionit 'goalseek' të MS Excel mund të përcaktojë vlerën e K që rezulton në VAN të përgjithshëm që barazohet me zero. Në rast të vendosjes së K në zero, përdoren 'goalseek' për të përcaktuar vlerën konstante të tarifave⁶]

12.4 Pasqyrat financiare dhe indikatorët

- 12.4.1 Rezultatët e analizave të tarifave unsmoothed dhe smoothed duhet të përcaktojnë pasqyrat financiare të parashikueshme para procesit të indeksimit: të hyrat (humbje e fitimit), pasqyra e bilancit dhe rrjedhja e parasë.
- 12.4.2 Pasqyrat e kontabilitetit duhet të reflektojnë uhdëzuesitë e kontabilitetit rregullator përkatësisht vlerën rregullatore të kapitalit.
- 12.4.3 Pasqyra e rrjedhjes së parasë është pasqyrë themelore financiare. Është e nevojshme të sigurohet që ofruesitë regjional të shërbimit të furnizimit me ujë operojnë me rrjedhjet pozitive ose gati pozitive të parasë duke e ditur kufizimet e tyre në sigurimin e financimit afatshkurt të mungesave negative.

⁶ Për tarifën uniforme konstante, metoda alternative duhet të ndajë VAN nga kërkesa e të hyrave me anët NP të vëllimit të shitjeve.

13. INDEKSIMI

13.1 Koncepti

- 13.1.1 Të gjitha kostot e përcaktuara në këto procedura vendosen sipas nivelit të tarifave në nivelin e çmimit të mesit të vitit para fillimit të periudhës së shqyrtimit të tarifave.
- 13.1.2 Tarifa fillestare duhet të vendoset në bazë të nivelit të çmimit në mes të vitit para fillimit të periudhës së shqyrtimit të tarifave 2008 dhe bazës së saj të tarifave të shumëzuar me indeksin e inflacionit për atë vit.
- 13.1.3 Tarifat pasuese duhet të përshtaten sipas shifrave të inflacionit të vitit të mëparshëm, d.m.th. tarifat 200X e përshtatur sipas indeksit të inflacioni për vitin (200X – 1).
- 13.1.4 Tarifat duhet të lejohen t'i përshtatin ndikimet e inflacionit duke u bazuar në indeksin e përgjithshëm krahasues të tarifave, apo, nëse është nevoja, të zbërthehen në komponentet përbërëse të inflacionit.

[Nuk rekomandohet që komponenti i tarifave të zbërthehet në shumë komponentë të ndryshëm. Më shumë rekomandohet që tarifa të zbërthehet në tre elemente: komponentit (nëse ka) që nuk duhet t'i nënshtrohet indeksimit; komponenti i energjisë dhe komponenti i non-energy (në bazë të asaj ku energjia mund të konsiderohet të jetë artikull i veçantë, me nivelin e konsumit në sektorin e ujit mundësisht më të madh se sa të atij të reflektuar në statistikat e përgjithshme të inflacionit të krahasimit të tarifave). Përveç kësaj, zbërthimi i tarifave në komponentë të ndryshëm paraqesin komplikimin shtesë se proporcioni i tarifave për çdo komponent nuk do të jetë konstant dhe do të nevojiteshin përshtatjet vjetore të proporcioneve, p.sh. nëse çmimi i energjisë rritet më shumë se shkalla e inflacionit të përgjithshëm atëherë do të rritet proporcioni i kostove të përgjithshme]

13.2 Metoda

- 13.2.1 Për vitin e parë (200X), tarifa inicuese e përcaktuar për çmimet e mesit të 200X-1 shumëzohet me shkallën e inflacionit në mes të 1 Janarit dhe 31 Dhjetor 200X-1 që të arrijë në bazë të çmimit në mes të 200X-1⁷
- 13.2.2 Tarifat e papërshtatura (unsmoothed) duhet të vendosen në Vitin 1 të tarifave dhe duhet të përshtaten çdo vit si:

$$\text{Tarifa}_t = \text{Tarifa}_{t-1} \times (1 + \text{RPI}_{t-1}) \times (1 + K_t)$$

Ku:

RPI_t = indeksi krahasues i tarifave t

$$K_t = [\text{Tarifa e paindeksuar}_t / \text{Tarifa e paindeksuar}_{t-1}] - 1$$

Shembull:

Tarifat e paindeksuara (çmimet të mesit të 200X), të llogaritura

$$200X+1 = \text{EUR } 0.60, \text{ dhe}$$

$$200X+2 = \text{EUR } 0.65$$

Shkallët e inflacionit:

$$200X = 7\%, \text{ dhe}$$

$$200X+1 = 8\%$$

Llogaritja:

$$\text{Tarifa}_{200X+1} = 0.60 \times (1 + 7\%) = \text{EUR } 0.642$$

$$K_{200X+2} = 0.65/0.60 - 1 = 8.33\%$$

⁷ Treguesit e inflacionit për 12 muaj të mëparshëm përdoren në bazë të të dhënave më të mira historike

$\text{Tarifa}_{2010} = 0.642 \times (1 + 8\%) \times (1 + 8.33\%) = \text{EUR } 0.751$

- 13.2.3 Nëse procedurat i adoptojnë një të njërit nga këto variante që përjashtojnë pjesët e tarifave nga indeksimi atëherë formula më lartë duhet të përshtatet në këtë mënyrë. Në të njëjtën mënyrë, nëse nevojitet të bëhet indeksimi ndaras të elementeve të tarifave, p.sh. komponent i kostos së energjisë, elementet e mbetura të tarifave duhet të indeksohen sipas indeksit të përgjithshëm të inflacionit që përjashton elementet specifike të indeksimit, p.sh. të gjitha items duke përjashtuar energjinë. Nëse nuk veprohet në këtë mënyrë atëherë do të vije deri te numërimi i dyfishtë të komponentëve të inflacionit.

13.3 Shqyrtimet e ardhshme të tarifave dhe vlera rregullatore e kapitalit

- 13.3.1 Procesi i indeksimit në mënyrë efektive siguron kthimin në vlerën rregullatore të kapitalit pas inflacionit. Ky kthim është ekuivalent me normën reale të kthimit të shumëzuar me vlerën rregullatore të indeksuar të kapitalit. Nuk ka nevojë për korrigjime (përshtatje) të vlerës rregullatore të kapitalit gjatë periudhës së shqyrtimit.
- 13.3.2 Për periudhat e ardhshme të shqyrtimit, vlera rregullatore e kapitalit duhet të përshtatet për inflacion, p.sh. për çmimet në mesin e vitit 2011 për përcaktimin e tarifave të periudhës 2012 – 2014.
- 13.3.3 Vlera rregullatore fillestare e kapitalit indeksohet sipas inflacionit gjatë periudhës së tërë të shqyrtimit pa shumat e zbritura (Amortizimi aktual i kostos apo ekuivalenti) të indeksuara nga koha kur janë bërë këto zbritje. Çfarëdo zbritje dhe shtesa tjera kundrejt vlerës rregullatore të kapitalit duhet të indeksohen nga koha e paraqitjes së tyre.